

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE, PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E MIGRACIONIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si qëllim ratifikimin e këtij protokollit sipas procedurave ligjore, të parashikuara në ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.622, datë 6.11.2023, ka miratuar, në parim, protokollin, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit.

Protokollin që propozohet për ratifikim ka si qëllim final për palën shqiptare, forcimin e marrëdhënies dhe të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, si një marrëdhënie me rëndësi të lartë për vendin tonë, në perspektivë edhe të pikësynimeve shqiptare për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në terma konkretë, kjo marrëdhënie synohet të intensifikohet në fushën e menaxhimit të flukseve migratore të parregullta, si një fenomen historikisht i pranishëm në rajon, çka lidhet edhe me objektivin e drejtpërdrejtë të tij (protokollit), të krijimit të kornizës bashkëpunuese për ngritjen e një qendre pritjeje të migrantëve të parregullt në territorin shqiptar, nga pala italiane, tërësisht me shpenzimet e kësaj të fundit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me objektivat dhe politikat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Brendshme.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të përgjithshëm të projektakteve, miratuar me vendimin nr.862, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë 2023”.

Për sa i përket raportit me programin politik të Këshillit të Ministrave, edhe pse projektligji dhe nisma nuk janë të parashikuar në mënyrë eksplicite në këtë program, sikurse e përmendëm në kreun pararendës të këtij relacioni, ato konsiderohen instrumente të rëndësishme në funksion të forcimit të marrëdhënies me vendin fqinj, si një marrëdhënie me rëndësi të lartë strategjike për Shqipërinë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Edhe pse nisma dhe propozimi fillestar për lidhjen e këtij protokollit kanë ardhur nga qeveria italiane, protokollit në vetvete paraqet rëndësi të veçantë gjithashtu për palën shqiptare. Kjo jo vetëm nisur nga prioriteti që ka për vendin tonë thellimi i marrëdhënies me Republikën Italiane, si partner i rëndësishëm, siç e argumentuam dhe më sipër, por edhe sepse objekti i protokollit që lidhet me mirëmenaxhimin e flukseve të migrantëve të parregullt është një çështje që paraqet interes edhe për vendin tonë dhe për rajonin në tërësi. Sikurse është e ditur tashmë, emigracioni i parregullt drejt vendeve evropiane dhe veçanërisht drejt Italisë është një fenomen që përfshin edhe rajonin tonë si pjesë e Mesdheut, i cili shpesh, përveçse burim në vetvete i emigracionit në fjalë, ka qenë edhe zonë kalimi tranzitore për migrantë të tillë. Në këtë kuptim, angazhimi ynë për frenimin e kontrollin e fenomenit në fjalë përbën jo vetëm një distancim nga imazhi i vjetër i Shqipërisë, si zanafilla e emigracionit të paligjshëm, por bën të mundur që efektivisht të dekurajohet ky fenomen në rajon, duke nxitur indirekt individët drejt formave të rregullta të lëvizjes, në përputhje me legjislacionin e vendeve respektive, atë evropian dhe ndërkombëtar.

Për sa më sipër, roli që merr përsipër Këshilli i Ministrave përmes këtij protokollit, duke kontribuar në menaxhimin e emigracionit drejt Italisë, ndihmon jo thjesht këtë të fundit drejtpërdrejt, por edhe Bashkimin Evropian në rrafshin e gjerë, për përballimin e një problematike që është bërë gjithnjë e më e ndjeshme gjatë dekadave të fundit. Rrjedhimisht, nëpërmjet kësaj sipërmarrjeje, vendi ynë do të rikonfirmojë pozitën e tij si një aleat i Bashkimit Evropian dhe si një kontribuues konkret në stabilitetin social të tij (BE-së). Në këtë kuptim, aspirata që nxit dhe mbështet në perspektivë këtë angazhim të Këshillit të Ministrave është ajo e integritit evropian të vendit.

Nëpërmjet këtij protokollit të kërkuar nga pala italiane, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër t'i vendosë në përdorim të përkohshëm qeverisë së Republikës Italiane një sipërfaqe pasurie shtetërore për t'u përdorur nga kjo e fundit për ngritjen e strukturave, ku fillimisht do të identifikohen e më pas do të akomodohen migrantët e parregullt që interceptohen në përpjekjen e tyre për të mbërritur në Itali. Sipërfaqet në fjalë janë dhe mbeten pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë, duke iu dhënë vetëm në përdorim të përkohshëm autoriteteve italiane (nenet 3 dhe 13 të protokollit). Pala shqiptare ruan të drejtën që të ripërtërijë ose jo protokollin në fund të afatit pesëvjeçar të saj, si dhe ta

zgjidhë/denoncojë atë, në përputhje me sa është parashikuar shprehimisht në tekstin e saj (neni 13).

Gjithashtu, duhet sqaruar fakti se në protokoll, në një sërë dispozitash, parashikohet se të gjitha shpenzimet për zbatimin e kësaj sipërmarrjeje i përkasin palës italiane, e cila do duhet të paguajë edhe çdo kosto që i vjen palës shqiptare, si pasojë e këtij protokollit. Detajet për mënyrën e shlyerjes së këtyre kostove nga pala italiane janë përcaktuar në aneksin dy (protokoll financiar), që miratohet si pjesë e pandarë e këtij protokollit, në përputhje me sa është parashikuar në nenin 10, të këtij protokollit.

Më tej, lidhur me riskun hipotetik social, që ka të bëjë me qëndrimin në territor shqiptar të migrantëve të huaj, sqarojmë se në protokoll është parashikuar detyrimi i palës italiane për t'i akomoduar këta migrantë (me shpenzimet e saj), vetëm brenda strukturave të ngritura në sipërfaqen në fjalë, si dhe për t'u kujdesur dhe garantuar se ata do të mbeten brenda këtyre strukturave. Për më tepër, në protokoll është përcaktuar qartë se numri i migrantëve që mund të strehohen në të njëjtën kohë në territorin shqiptar është i kufizuar dhe nuk mund të kalojë 3 mijë veta (neni 4, pika 1, e protokollit). Në të njëjtën linjë, në protokoll parashikohen mënyrat e ndërveprimit ndërmjet autoriteteve respektive të palëve, në rast daljeje të paautorizuar të migrantëve, me qëllim rishoqërimin e tyre pranë strukturave të ngritura dhe administruara nga pala italiane (pika 6, e nenit 6). Në çdo rast, nëse hipotetikusht nuk do të respektohen detyrimet nga pala italiane, siç e theksuam edhe më sipër, pala shqiptare ka të drejtën e denoncimit dhe zgjidhjes së protokollit në mënyrë të njëanshme, në përputhje me sa parashikohet në nenin 13 të tij (protokollit).

Nisur nga garancitë e mësipërme, vlerësojmë se protokollit nuk paraqet problematika reale, në kuptim të përkeqësimit të pozitës apo të interesave të palës shqiptare, pasi këto janë parandaluar përmes dispozitave që përmendëm më parë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozon ratifikimin e protokollit, në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës dhe me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për çështjet që parashikohen në nenin 121, pika 1, të Kushtetutës, detyrimisht i nënshtrohen ratifikimit, ndërsa marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Këshillit të Ministrave mund të hyjnë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi, nëse kjo parashikohet shprehimisht në tekstin e marrëveshjet ose kur parashikohet në rastet e përcaktuara në nenin 121 të Kushtetutës.

Në këtë drejtim, ky protokoll, pavarësisht se nuk rregullon çështje që lidhen me nenin 121, pika 1, të Kushtetutës, por rregullon vendosjen në pozicion të një sipërfaqeje toke, si dhe duke pasur në konsideratë që mbi atë sipërfaqe toke, për çështje të caktuara, ushtron autoritetin e saj pala italiane, duke u bazuar në nenin 121, pika 2, të Kushtetutës, propozohet ratifikimi i tij nga Kuvendi.

Për sa i përket faktit se në sipërfaqen e sipërpërmendur do të ushtrojnë kompetenca të caktuara organet e kësaj pale, theksojmë se ka mjaft shembuj të marrëveshjeve të tjera, përmes së cilave shtetet palë u njohin organeve të tjera të drejtën për të ushtruar kompetenca të caktuara në territorin e tyre në përputhje me qëllimet dhe objektivat e marrëveshjeve, sipas rastit. Kujtojmë këtu marrëveshjen statutore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë (në vijim Agjencia). Në bazë të kësaj marrëveshjeje të lidhur ndërmjet vendit tonë dhe Bashkimit Evropian, agjencia e posaçme e këtij të fundit mund të marrë kompetenca ekzekutive në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të zhvillimit të veprimeve dhe operacioneve të ndryshme për trajtimin e emigracionit të paligjshëm dhe të krimeve ndërkufitare. Përmendim këtu se një ndër këto lloje operacionesh janë edhe “operacionet e kthimit”, që nënkuptojnë “operacion që koordinohet nga Agjencia dhe përfshin përforsim teknik dhe operacional, që ofrohet nga një ose më shumë shtete anëtare, sipas të cilit të kthyerit nga një ose më shumë shtete anëtare kthehen në Republikën e Shqipërisë ose mbi baza të detyruara ose vullnetare”. Kjo marrëveshje është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.6/2019. Përpos kësaj, theksojmë se në të njëjtën fushë është nënshkruar tashmë edhe një marrëveshje tjetër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për aktivitetet operacionale të kryera nga Agjencia, e cila pritet të dërgohet për ratifikim pranë Kuvendit së shpejti. Kjo marrëveshje ka për synim të trajtojë të gjitha aspektet që janë të nevojshme për kryerjen e veprimeve nga Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare në territorin shqiptar, gjithnjë në sferën e çështjeve të sipërpërmendura (ku përfshihet trajtimi i migracionit si aspekt kryesor).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji, përmes të cilit propozohet ratifikimi i këtij protokollit, është i përbërë nga 2 nene, si më poshtë vijon:

Neni 1 parashikon ratifikimin e këtij protokollit dhe finalizimin e procedurave

ligjore të parashikuara në ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 parashikon se ky projektligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

Për sa i përket përmbajtjes së vetë protokollit, sqarojmë si më poshtë vijon:

Protokolli përmban gjithsej 14 nene:

Neni 1 parashikon përkufizimin e termave të përdorur në protokoll, nga të cilët përmenden përkufizimet, ndër të tjera, të termave “zonë”, “migrantë” dhe “personel italian”.

Neni 2 parashikon se ky protokoll ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh, ndërmjet palëve për menaxhimin e flukseve migratore nga vendet e treta, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe atë evropian.

Neni 3 përcakton se pala shqiptare i jep palës italiane të drejtën për përdorimin e zonave, sipas kushteve të përcaktuara në protokoll, pa kundërshtim për gjithë kohëzgjatjen e saj, në përputhje me sa është parashikuar në nenin 13.

Neni 4, në pikën 1 të tij, përcakton se pala italiane mund të krijojë në zonat e përcaktuara strukturat e përmendura në aneksin 1, si dhe se numri i përgjithshëm i migrantëve të pranishëm njëkohësisht në territorin shqiptar nuk mund të jetë më i lartë se 3 000 (tre mijë).

Në pikën 2 parashikohet se strukturat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, drejtohen nga autoritetet e palës italiane, sipas legjislacionit italian dhe atij evropian dhe se mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet këtyre autoriteteve dhe subjekteve që do të akomodohen në struktura i nënshtrohen ekskluzivisht juridiksionit italian.

Në pikën 3 parashikohen rregullat për hyrjen dhe qëndrimin në territorin shqiptar të migrantëve të strehuar në struktura dhe, në rast se e drejta e qëndrimit në struktura nuk gjen zbatim, pala italiane i transferon menjëherë migrantët nga territori shqiptar. Transfertat për dhe nga strukturat në fjalë janë përgjegjësi e autoriteteve kompetente italiane.

Pika 4 parashikon rregullat për hyrjen e migrantëve në ujërat territoriale dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe se në momentin e mbërritjes në territorin shqiptar autoritetet kompetente të secilës prej palëve do të vijojnë veçmas me përmbushjen e kriterëve të parashikuara nga dispozitat ligjore kombëtare përkatëse, si edhe duke iu përmbajtur kushteve të këtij protokollit.

Pika 5 parashikon se shpenzimet për përshtatjen e një apo më shumë strukturave të hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të migrantëve mbulohen tërësisht nga pala italiane.

Pikat 6 e në vazhdim të këtij neni parashikojnë rregullat për kujdesin shëndetësor të migrantëve, ku përfshihen krijimi i strukturave shëndetësore, karantinimi dhe trajtimi i migrantëve mbartës të sëmundjeve infektive, sipas protokolleve shëndetësore nga ana e palës italiane, bashkëpunimi i autoriteteve të palëve për të siguruar kujdesin mjekësor thelbësor e të domosdoshëm ndaj personave të strehuar në këto struktura, si dhe detyrimi që kostot për shërbimet shëndetësore që do të ofrohen nga pala shqiptare të paguhen nga pala italiane.

Neni 5 parashikon se strukturat e përmendura në aneksin 1 do të ndërtohen dhe menaxhohen në përputhje me legjislacionin italian, pa pasur nevojë për leje ndërtimi apo formalitete të tjera të ngjashme, të kërkuara nga legjislacioni shqiptar, por me detyrimin e vetëm për t'i njoftuar paraprakisht palës shqiptare projektin e dokumentacionin lidhur me qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e strukturave.

Gjithashtu, pala italiane angazhohet të ndërtojë edhe strukturat e nevojshme ose ambiente lehtësuese dhe për personelin shqiptar, që do të ruajë perimetrin e jashtëm të strukturave, ndërsa pala shqiptare lehtëson ofrimin e shërbimeve të nevojshme për funksionimin e strukturave, për të cilat do të zbatohen kushte jo më pak të favorshme se ato që zbatohen për struktura të ngjashme.

Kostot për sigurimin e këtyre shërbimeve mbulohen tërësisht nga pala italiane.

Në pikën 4 parashikohen përjashtimet nga taksat dhe detyrimet doganore indirekte për shpenzimet e bëra nga pala italiane për ndërtimin e strukturave, megjithatë, pala italiane nuk do të kërkojë përjashtime nga taksat ose pagesat e tjera, pavarësisht emërtimit, që janë tarifa për përdorimin e shërbimeve publike.

Gjithashtu, për nevojat e ndërtimit e të menaxhimit të strukturave, pala italiane përjashtohet nga kufizimet ose kontrollet e monedhës dhe mund të transferojë lirisht monedha, pavarësisht dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pika e fundit parashikon angazhimin e palës shqiptare për lehtësimin e kryerjes së praktikave doganore për materialet dhe pajisjet e kërkuara nga pala italiane.

Më tej, neni 6 parashikon rregullat në lidhje me sigurinë e zonave, ku parashikohet se palët bashkëpunojnë për ruajtjen e sigurisë së tyre. Përkatësisht, pala shqiptare siguron ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në perimetrin e jashtëm të strukturave dhe gjatë transportit tokësor drejt dhe nga të njëjtat struktura që kryhet në territorin shqiptar, ndërsa pala italiane siguron ruajtjen e rendit dhe të sigurisë brenda zonave, si dhe parashikohen edhe rregullat për hyrjen e autoriteteve kompetente shqiptare në zonë. Secila palë do të ngrejë një njësi

përgjegjëse për mbarëvajtjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve të sigurisë.

Në vijim, po në këtë nen parashikohet se pala italiane merr masat e nevojshme për të siguruar qëndrimin e migrantëve brenda zonës, duke mos lejuar daljen e paautorizuar të tyre në pjesën tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë. Në rast daljeje të paautorizuar, autoritetet shqiptare do t'i shoqërojnë ata pranë strukturave dhe kostot për këtë veprimtari do të mbulohen nga pala italiane. Gjithashtu, pala italiane do të përballojë çdo shpenzim për akomodimin dhe trajtimin e subjekteve që do të strehohen në struktura. Dokumentet zyrtare të mbajtura në çfarëdo lloj cilësie nga autoritetet italiane dhe nga personeli italian i dërguar në Shqipëri përjashtohen nga sekuestrimi ose masa të tjera të ngjashme nga autoritetet shqiptare.

Në vijim, neni 7 parashikon rregullat në lidhje me njoftimin e emrave të personelit italian, përjashtimin nga vizat, lejen e qëndrimit dhe formalitetet e tjera të kërkuara nga legjislacioni shqiptar për migracionin të personelit italian për qëllimet e përcaktuara në këtë protokoll, zbatimin e legjislacionit italian për kushtet e punës së tyre, përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat dhe kontributet për dhënien e ndihmës sociale të parashikuara nga legjislacioni shqiptar të pagave të tyre, përveç rasteve kur personi i punësuar në qendër është shtetas shqiptar, rezident në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrimin për respektimin ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ndërhyrjen në punët e saj të brendshme. Personelit italian, i cili qëndron në territorin shqiptar për më shumë se 90 ditë, i lëshohet pa pagesë dhe me një kërkesë të thjeshtë një dokument identifikimi (leje unike).

Në pikën 4 parashikohet se për fjalët dhe për veprimet e kryera në ushtrimin e funksioneve të tyre personeli italian nuk i nënshtrohet juridiksionit shqiptar edhe pas përfundimit të ushtrimit funksioneve të lartpërmendura në territorin shqiptar dhe se komunikimet e personelit me autoritetet kompetente italiane nuk i kufizohen nga autoritetet shqiptare. Megjithatë, në pikën 5 parashikohet se përjashtimisht nga sa është përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, personeli italian është përgjegjës, sipas legjislacionit shqiptar, nëse gjatë qëndrimit dhe periudhës së parashikuar në këtë protokoll, kryen jashtë orarit të shërbimit vepra penale të parashikuara nga ky legjislacion, që cenojnë të drejtat e shtetasve shqiptarë apo të shtetit shqiptar.

Pa cenuar pikën 4, të këtij neni, personeli italian gëzon imunitet nga çdo formë ndalimi në Shqipëri, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 5, në të cilin çështja do të trajtohet sipas legjislacionit procedural penal shqiptar dhe marrëveshjeve dypalëshe në fuqi. Në rastet e parashikuara në pikën 5, për zbatimin e masave të sigurimit personal ndaj personelit italian, autoritetet shqiptare duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet italiane.

Më tej parashikohen rregullat për trajtimet mjekësore urgjente të personelit italian në institucionet e kujdesit shëndetësor shqiptar, shpenzimet për të cilat përballohen nga vetë personi ose nga pala italiane.

Pikat 9 e 10 parashikojnë rregullat për njoftimin e listës emërore të personave të autorizuar për të mbajtur armë gjatë ushtrimit të detyrës, së bashku me dispozitat përkatëse të marrjes dhe dorëzimit të armës nga këta persona. Personelit i ndalohet të mbajë armë në territorin shqiptar jashtë orarit të shërbimit, ku në shërbim përfshihet edhe shoqërimi i migrantëve nga dhe për në struktura. Pala italiane angazhohet të marrë masa për garantimin e sigurisë për ruajtjen e armatimeve dhe të municioneve të përdorura.

Neni 8 përcakton se hyrja në territorin shqiptar e mjeteve të palës italiane do të rregullohet me protokolle të tjera që do të lidhen ndërmjet autoriteteve italiane e atyre shqiptare dhe se procedura e transferimit të migrantëve drejt zonave dhe nga këto zona kryhet në përputhje me këto protokolle. Kostot e angazhimit të mjeteve dhe forcave pjesëmarrëse të palës shqiptare do të mbulohen nga pala italiane.

Neni 9 parashikon kohëzgjatjen maksimale të qëndrimit të migrantëve në territorin e Republikës së Shqipërisë sa periudha maksimale e lejuar nga legjislacioni italian përkatës. Në përfundim të procedurave të kryera sipas legjislacionit italian, pala italiane do të largojë migrantët nga territori shqiptar dhe se shpenzimet për këto procedura do të mbulohen tërësisht nga pala italiane. Me qëllim garantimin e së drejtës për t'u mbrojtur, palët do të lejojnë hyrjen në struktura të avokatëve, të ndihmësve të tyre, të organizmave ndërkombëtarë dhe agjencive të Bashkimit Evropian, që ofrojnë këshilla dhe asistencë për azilkërkuesit, sipas legjislacionit italian, evropian dhe shqiptar të zbatueshëm.

Gjithashtu, në rast lindjeje dhe vdekjeje, migrantët do t'u nënshtrohen dispozitave të legjislacionit italian. Për rastet e vdekjeve, pala shqiptare do të vëre në dispozicion të palës italiane strukturat e morgut dhe pala italiane do të transferojë trupin nga territori shqiptar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga fakti i vdekjes.

Neni 10 përcakton se shpenzimet e parashikuara në nenet 4, 6, 8 e 12 do t'i rimbursohen palës shqiptare nga pala italiane *a forfait*, në masën dhe mënyrat që përcaktohen në aneksin 2, rregullat e të cilit do të zbatohen gjithashtu për sa i përket detyrimit që ka pala italiane për të marrë përsipër shpenzimet e kryera nga pala shqiptare, në rast të nisjes nga ana e migrantëve të procedurave administrative pranë autoriteteve kompetente shqiptare.

Neni 11 parashikon se në përfundim të afatit të protokollit, pala italiane i kthen palës shqiptare zonat e vëna në përdorim, pa detyrim kundërshpërblimi për përmirësimet e kryera, si dhe merr përsipër largimin nga territori shqiptar të të gjithë migrantëve, deri në përfundimin e afatit saj.

Neni 12 parashikon se secila palë dëmshpërblen dëmet e shkaktuara palës tjetër nga sjellja e keqe qëllimshme ose neglizhenca e rëndë e personelit të saj dhe humbjet që rrjedhin nga çdo detyrim për të kompensuar palët e treta për dëmet e shkaktuara atyre nga sjellja e keqe e qëllimshme ose neglizhenca e rëndë e personelit të tjetrit. Nuk do të konsiderohen sjellje e keqe apo neglizhencë mungesat në shërbim, që vijnë si pasojë e kapaciteteve objektive të kufizuara të palëve. Në pikën 2, të këtij neni, përcaktohet se, me sa është parashikuar nga neni 10, pala italiane angazhohet se do të mbulojë koston për përfaqësimin dhe kostot që mund të vijnë si pasojë e gjykimit për çdo padi që mund të ngrihet ndaj Republikës së Shqipërisë nga palë të treta, e cila buron nga lidhja e këtij protokollit dhe zbatimi i saj, përfshirë veprimet apo mosveprimet e palës italiane ndaj subjekteve migrantë apo për shkak të veprimtarisë së autoriteteve italiane. Për rastet e përmendura në këtë nen, palët do të nxisin diskutime në mirëbesim, që synojnë arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme në mënyrë të ndërsjellë.

Neni 13 përcakton rregullat për hyrjen në fuqi të protokollit dhe mbetjen e saj në fuqi për një periudhë 5-vjeçare, si dhe ripërtëritjen në formë të heshtur për një periudhë tjetër 5-vjeçare, nëse njëra nga palët nuk i komunikon palës tjetër, të paktën gjashtë muaj përpara afatit të përfundimit të këtij protokollit, qëllimin e saj për të mos e rinovuar këtë protokoll. Më tej, parashikohen rregullat për denoncimin e protokollit.

Në vijim, në nenin 14 përcaktohet se çdo kundërshti ndërmjet palëve lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij protokollit, si edhe të protokolleve të tjera që rrjedhin prej saj, do të zgjidhet në formë miqësore nëpërmjet konsultimit mes palëve.

Aneksi 1, siç e shpjeguar edhe më sipër, përmban hartat e dy zonave që i vendosen në përdorim palës italiane në funksion të zbatimit të këtij protokollit, respektivisht “Zona për ngritjen e strukturave për procedurat e hyrjes”, si dhe “Zona për realizimin e strukturave për verifikimin e kushteve të njohjes së mbrojtjes ndërkombëtare dhe për riatdhesimin e migrantëve që nuk kanë të drejtë hyrjeje dhe qëndrimi në territorin italian” (zona që do të përdoret për pritjen dhe akomodimin e migrantëve).

Së fundi, aneksi 2 përmban rregullat e hollësishme për mënyrën e shlyerjes nga pala italiane drejt palës shqiptare të kostove që kësaj të fundit i vijnë nga zbatimi i këtij protokollit, sikurse është referuar edhe në dispozitat përkatëse të tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji do të jenë Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e

Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Avokatura e Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Propozimi fillestar për këtë protokoll është paraqitur nga pala italiane, e cila ka qenë nismëtarja për këtë çështje. Pranë Kryeministrit është paraqitur interesi i qeverisë së Republikës Italiane, nëpërmjet ambasadorit të Republikës së Italisë, me notën e tij nr.2139, të datës 23 maj 2023, për këtë qëllim. Në vazhden e diskutimeve që lindën nga kjo shprehje interesi, pala italiane dërgoi sërish, nëpërmjet ambasadorit të saj, shkresën nr.3071, datë 21.7.2023 (nr.2333/1 prot. hyrës, datë 21.8.2023), në të cilën përcillet një draft fillestar, i hartuar nga pala italiane për projektprotokollin. Në vijim të kësaj shkrese, është ngritur grupi ndërinstytucional i punës me urdhrin nr.99, datë 25.8.2023, të Kryeministrit. Në mbështetje të këtij urdhri, grupi ndërinstytucional ka zhvilluar takime dhe bisedime me përfaqësues të palës italiane për përmbajtjen e projektprotokollit. Në vijim të komunikimeve dhe takimeve të zhvilluara, janë përcjellë prej palës italiane edhe shkresa nr.3643, datë 5.10.2023 (nr.2333/3 prot. hyrës, datë 6.10.2023), e cila reflektonte ndryshimet në tekst, sipas bisedimeve të zhvilluara ndërmjet grupit të punës dhe përfaqësuesve të palës italiane.

Së fundi, drafti i dakordësuar ndërmjet grupit të punës dhe palës italiane është përcjellë nga ambasadori italian me shkresën nr.3836, datë 23.10.2023, (nr.2333/5 prot. hyrës, datë 23.10.2023) dhe me notën verbale nr.4032 prot., datë 3.11.2023.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka kosto financiare për buxhetin e shtetit, pasi të gjitha shpenzimet për zbatimin e protokollit do të mbulohen nga pala italiane, sikurse u sqarua edhe në kërçet pararendës të këtij relacioni.

KËSHILLI I MINISTRAVE